

## Trajnim “Auditimin e Teknologjisë së Informacionit në Sistemin e Thesarit në Shqipëri

### Mbështetje e Sigma-s për Kontrollin e Lartë të Shtetit

Tiranë, 16 -18 Shtator 2013

Me zhvillimin e teknologjisë së informacionit, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, po bëhen gjithnjë e më të ndërvarura nga sistemet e kompiuterizuara të informacionit për të realizuar funksionet e tyre dhe mbi të gjitha për raportimin dhe informimin efektiv. Për këtë arsye besueshmëria të dhënave të dixhitale dhe sistemeve që i përpunojnë këto të dhëna po bëhet tashmë një nga çështjet kryesore në fokus të auditimit. Nëpërmjet Auditimeve të Teknologjisë së Informacionit vlerësohet besueshmëria e të dhënave të gjeneruara nga sistemet kompiuterike të cilat mbështesin deklaratat financiare, analizohen programe specifike si dhe produktet e tyre. Për më tepër këto auditime shqyrtojnë mjaftueshmërinë e kontroleve në sistemin e informacionit si dhe operacione të tjera të cilat sigurojnë efektivitetin e këtyre sistemeve.

*Zhvillimi i sistemit AMoFTS (Albanian Ministry of Finance Treasury System) (E-Business Suite Oracle) drejt një sistemi modern për procedimin e transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme bazuar në standardet dhe praktikat ndërkombëtare për raportimin financiar, përdorimin e likuiditeteve dhe pasurisë së qeverisjes së përgjithshme me ekonomi, eficiency, efektivitet dhe transparence sjell në vëmendje të KLSH një fushë të re të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit.* Në vitin 2003 Qeveria Shqiptare vendosi të krijojë një sistem të ri të kompiuterizuar të thesarit, i cili synonte të jepte përgjigjen e shume pyetjeve dhe problemeve që kishin dalë gjatë viteve në procesin e ekzekutimit dhe raportimit buxhetor. Sistemi i Ri i Thesarit *on line* u projektua dhe filloi të implementohej në 36 Zyra të Rretheve por duke u përballur me vështirësi dhe probleme të cilat kërkonin zgjidhje të tjera. Objektivi i përgjithshëm i vendosjes së Sistemit Elektronik të Thesarit është fuqizimi i menaxhimit financiar publik në Shqipëri në pajtueshmëri me Partneritetin Europian dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Në mars 2012 problemet dhe çështjet kyc filluat të zgjidheshin dhe përfundimisht sistemi tashmë është plotësisht i integruar *on line* me Bankën e Shqipërisë ashtu dhe me bankat e nivelit të dytë. Në strategjinë afatgjatë të qeverisë përcaktimi si prioritet i zgjerimit dhe mbulimit të të gjithë institucioneve buxhetore me këtë sistem për një periudhë 10-vjecare, thekson funksionet kryesore të Thesarit: monitorimin, menaxhimin e likuiditeteve të qeverisë, kontrollin financiar para pagesave dhe përgatitjes së raporteve të konsoliduara financiare për qeverinë. Kjo do të thotë se Auditimi i Sistemit të Kompiuterizuar të Thesarit është një e ardhme jo e largët për KLSH.

Për këtë arsye **Projekti “ SIGMA mbështetje për KLSH”, me kërkesën e Kryetarit dhe duke vlerësuar nevojat aktuale të stafit për trajnime në fushën e teknologjisë së informacionit, më 16 deri 18 Shtator 2013, në Tiranë zhvilloi seminarin me temë: “Auditimi Teknologjisë së Informacionit në Sistemin e Thesarit në Shqipëri”**

#### **Qëllimi i trajnimit**

Trajnimi mbi Auditimin e Teknologjisë së Informacionit kishte si qëllim kryesor rritjen e kapaciteteve audituese të stafit të KLSH, nëpërmjet sjelljes së njohurive të reja për audituesit dhe aftësimin e tyre për t’iu përshtatur kërkesave të profesionit në kryerjen e auditiveve të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Synimi i trajnimit ishte që të :

- Kuptohet sistemi i Thesarit nga këndvështrimi i TI
- Aftësojë stafin për të audituar sistemin e Thesarit
- T'i mundësojë audituesit të testojnë të dhëna reale dhe nxjerrin përfundime mbi bazën e tyre

### **Objektivat dhe përmbajta e trajnimit**

Trajnimi tre ditor “ Mbi Auditimin e TI ne Sistemin e Thesarit” trajtoi njohuri të përgjithshme të auditimit të sistemeve të informacionit si dhe Sistemit Kompjuterik të Thesarit në Shqipëri. Axhenda e trajnimit përfshinte njohuri të gjera të kontrolleve që kërkohen kur auditohen sistemet e informacionit, si për sistemet ekzistuese ashtu dhe procedura te reja të zhvilluara, ashtu dhe veprimtari të tjera që kryhen në departamentin e teknologjisë së informacionit.

Ky trajnim ishte disenjuar për auditues me *background* financiar , inxhinierik dhe të TI të cilët duhet të pajisen dhe përditësojnë njohuritë e tyre teknike dhe operacionale për të audituar sistemet e teknologjive te informacionit . Duke u fokusuar në një model mbi bazë risku dhe nga lart-poshtë të auditimit të transaksioneve të aplikimit të sistemit, pjesëmarrësit u njohën me teknika të cilat mund të aplikohen në të gjitha llojet e aplikimeve që nga *batch*, në *on-line* deri në *real-time*.

Objektivat specifikë të trajnimit përshinë:

- Konceptet e teknologjisë së informacionit lidhur me risqet kyç në ambientin e IT.
- Shqyrtimin e fushave te IT si sistemet operative, sistemet e menaxhimit të dhënave dhe rrjetet.
- Konceptet e auditimit te IT që duhet të njohë dhe të dijë një auditues për të audituar efektivisht sistemet e aplikimeve ekzistuese.

Ky trajnim iu ofroi pjesëmarrësve një bazë të qëndrueshme të njohurive thelbësore mbi teknologjinë e informacionit në aplikimin e risqeve të IT, auditimit, sigurisë së informacionit dhe sistemeve të aplikimit të biznesit.

### **Çështjet në fokus të seminarit:**

Trajnimi ofroi një tërësi teknikash të cilat mund të përdoren në auditimin e sistemeve të auditomatizuar si dhe menaxhimin e aktivitetit të transaksionit të aplikimit, kontrolleve dhe procedurave. Pjesëmarrësit u njohën me mjetet e testimit në fushë/teren për identifikimin, regjistrimin, përcaktimin dhe vlerësimin e kontrolleve dhe procedurave të aplikimit.

Çështjet kryesore në fokus të seminarit përfshinë trajtimin në detaje të fushave të mëposhtme.

- Njohja me CoBit si një nga standardet për Auditimin e TI
- Strategjia e integruar e auditimit dhe fokusi në risqet e sistemit.
- Kontrollat e përgjithshme të IT dhe impakti i tyre në besueshmërinë e kontrolleve te aplikimit
- Kontrollat e rëndësishme të aplikimit dhe impakti i tyre në proceset e sistemit të Thesarit.
- Metodat për testimin e kontrolleve të automatizuara dhe manuale

- Metodatat e dokumentimit të proceseve të It dhe kontrolleve.
- Roli i përdoruesve dhe ndarja e punës.
- Konceptit i rrjeteve dhe impakti i tyre objektivat e subjektit dhe sigurisë së tij.
- Rëndësia e database-t për sigurinë e informacionit

Njohuritë teknike mbi IT u kombinuan me njohuri mbi sistemin e Thesarit dhe proceset e aplikimit të tilla si:

- Buxhetimi
  - Përgatitja e parashikimeve, konsolidimi dhe miratimi
  - Shumat, ndarja e buxhetit dhe dhënia e buxhetit
- Prokurimet dhe menaxhimi i pagesave
  - Urdhër pagesat, kërkesat për shpenzime
  - Kryerja e pagesave
- Menaxhimi i të ardhurave dhe Cash-it
  - Të ardhurat, bashkërendimi i të ardhurave dhe shpërndarja
  - Bashkërendimi i deklaratave bankare, parashikimi i Cash-it
- Menaxhimi i aseteve fikse
  - Menaxhimi Off-line i aseteve fikse, libri i llogarive i aseteve fikse
  - Menaxhimi On-line i aseteve fikse, shtimi i aseteve, transaksionet e aseteve dhe amortizimi
- Kontabiliteti dhe raportimi financiar
  - Libri i Llogarive të Përgjithshme, periudha e mbylljes

Auditimi i IT është procesi i mbledhjes dhe vlerësimit të evidencës për të përcaktuar nëse një sistem kompiuterik është projektuar për të ruajtur integritetin e të dhënave, mbrojtjen e aseteve, lejon të arrihen objektivat e entitetit/njesisë në mënyrë efektive si dhe përdorimin e burimeve me efektivitet. Një sistem informacioni efektiv udhëheq entitetin/organizatën drejt arritjes së objektivave dhe një sistem eficient përdor minimumin e burimeve në arritjen e objektivave të kërkuara. Për këtë arsye një auditues i IT-se duhet të njohë karakteristikat e përdoruesve të sistemit të informacionit dhe vendimmarrjen në subjektin e audituar kur ai vlerëson efektivitetin e çdo sistemi

### **Pjesëmarrësit**

Përzgjedhja e stafit që mori pjesë në trajnim ishte një element tjerët i cili ndikoi në zhvillimin e një seminari efektiv dhe të dobishëm. Për këtë arsye një grup kërkesash të veçanta u vendosën si kriteret minimale për pjesëmarrësit . Këto kërkesa përfshinë:

- Të kenë eksperiencë dhe njohuri lidhur me Sistemin e Thesarit në Shqipëri
- Të kishin njohuri bazë mbi sistemet e informacionit dhe/ose të kishin qenë pjesëmarrës në Trajnimin e mëparshëm të organizuar nga SIGMA “ Mbi Auditimin e IT” në Dhjetor 2012;
- Të kishin motivim, nxitje dhe aftësi komunikuese dhe të punës në grup, pasi formati i seminarit parashikonte pjesën më të madhe të punës në grupe.

Gjithashtu u mbajt parasysh në përzgjedhje ruajtja e një ekuilibri të mjaftueshëm midis eksperiencës së audituesve të përvojës dhe vullnetit për të mësuar të audituesve të rinj.

### ***Lista e Pjesëmarrësve:***

Kristaq Gjyli, Albana Agolli, Manjola Naco, Bajram Lamaj, Ermal Yzeiraj, Bashkim Harizaj, Muhamet Kavaja, Albert Thoma, Evis Cela, Selime Bregu, Nikoleta Piranjan, Nerexa Llapashtica, Valentina Golemi, Edvin Stefani, Hektor Kosova, Julian Adili, Kozma Kondakciu, Armanda Begaj, Albana Gjinopulli, Ergis Tafalla.

### **Përbërja e trajnerëve**

Trajnimi u konsiderua si një vazhdimësi e trajnimit që u zhvillua nga SIGMA në Dhjetor 2012 dhe kishte si objektiv kryesor prezantimin e audituesve me njohuritë bazë për auditivin e TI . Për këtë arsye nga SIGMA u kontraktua z. Peter Gresel konsulent, i mbështetur dhe moderuar nga z. Joop Vrolijk.

1. Z. Joop Vrolijk, Këshilltar, Zyrtar i Lartë i SIGMA-s
2. z. Peter Gresel. Konsulent, Republika Çeke.

### ***Çështje të diskutuara dhe për diskutim në të ardhmen.***


Në trajnim u përdorën një miks seksionesh me prezantime, diskutime interaktive në grup dhe ushtrime apo raste studimore të cilat ndihmuan në arritjen e qëllimit dhe objektivave të workshop-it. Një risi e seminarit ishte se rastet studimore u bazuan në të dhëna faktike të ofruara nga ministria e financave , ç'ka i ndihmoi audituesit për të qenë dhe më afër realitetit në zgjidhjen e problemeve. Megjithatë , procedurat, instruksionet e punës dhe të dhenat janë raste tipike të cilat mund të lidhen dhe të përdoren në sisteme të tjera në të njëjtën formë dhe mënyrë. Rastet studimore u hartuan me kujdes duke u fokusuar në çështje të cilat dalin më shpesh dhe kërkojnë zgjidhje gjatë auditiveve të Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit.

### ***Feedback- Vlerësimi i seminarit.***

Në fund të seminarit, pjesëmarrësve iu dha mundësia të shprehnin vlerësimin e tyre të përgjithshëm mbi përmbajtjen e seminarit, ecurinë dhe së fundi mësimet e nxjerra. Disa prej audituesve me eksperiencë të gjatë në KLSH si auditues po ashtu dhe drejtues të nivelit të lartë u shprehën me nota mjaft pozitive lidhur me mënyrën e organizimit dhe përmbajtjen e seminarit. Z. Bajram Lamaj, Drejtori i Departamentit të Auditimit vlerësoi përgatitjen dhe prezantimin e bërë nga konsulenti z. Peter Gresel dhe njëkohësisht propozoi që iniciativa të tjera lidhur me auditivin e sistemeve të TI të mund të nxiten në të ardhmen. Kjo theksoi ai – lidhur ndjeshëm me përmirësimin e punës audituese në KLSH, në kohën kur jo vetëm Ministria e Financave ka adoptuar Sistemin Elektronik të Thesarit por tashmë gjithnjë e më shumë institucionet buxhetore po aplikojnë sisteme të teknologjisë së informacionit. Njohuri të tilla do të na shërbenin që fusha të tilla si kontrollet dhe siguria dhe besueshmëria e informacionit të gjeneruar nga sistemet e TI të mos mbeten jashtë fokusit të punës së audituesve të KLSH.

Znj. Nikoleta Piranjan në cilësinë jo vetëm të audituese së lartë por dhe më mes humb eksperiencë në fushën e auditimit të Thesarit të Shtetit, cilësoi përfitimet nga ky workshop, pot njëkohësisht theksoi nevojën e thellimit të këtij trajnimi dhe në mënyrë të veçantë për atë grup auditimi i cili do të përfshihet në auditivin e këtij sistemi. Në vijim z. Albert

Thoma, Kryeauditues dhe pjesëmarrës të tjerë e vlerësuan trajnimin si shumë të dobishëm dhe me vlera për të ardhmen e tyre si auditues.



**Përgatiti Albana Gjinopulli, Përgjegjëse e Sektorit të Trajnimeve, KLSH**